

25.03.2022

**STATUTI & AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“AR MEDICAL” shpk**

Roberta Spada qytetare italiane, e lindur më 24-08-1967 në Itali e identifikuar me Kartën e Identitetit AU 4762275

Angelo Costantiello qytetar italian, i lindur më 31.08.1973 në Conversano BA e identifikuar me Kartën e Identitetit AR3571586;

të cilët vendosën të nënshkruajnë këtë Akt Themelimi të një Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar (në vijim do të referohet si “Shoqëria”) aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti si pjesë integrale e këtij Akti.

Neni 1 – EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë do të jetë “AR MEDICAL” shpk

Neni 2 – Selia Ligjore

Selia ligjore e shoqërisë do të jetë në adresën Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati II, Tiranë.

Neni 3 –Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

Neni 4 – Objekti i Shoqërisë

4.1 a) Tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve mjekësorë, ortopedikë dhe paramjekësorë, duke përfshirë tregtimin me shumicë të instrumenteve dhe pajisjeve për përdorim mjekësor dhe spitalor;
b) shitjen dhe dhënien me qira të pajisjeve për trajtimin, analizën dhe mirëqenien e trupit;
c) projektimin, zhvillimin e hardëare dhe softëare, si për vete ashtu edhe në emër të palëve të treta, të aplikacioneve mjekësore dhe/ose paramjekësore si dhe shpërndarjen e tyre (shitje, dhenie në përdorim, ekskluzivitet), shërbimet e instalimit, si për vete ashtu edhe me tenderim, mirëmbajtje, si për vete ashtu edhe me tenderim, të sistemeve të çdo lloji dhe madhësie dhe të të gjitha aksesorëve dhe pjesëve të këmbimit.
Në mënyrë instrumentale për sa më sipër, shoqëria mund të kryejë edhe aktivitetet e mëposhtme:
përfaqësimin e artikujve të listuar në pikat a, b dhe c.;
furnizimin me shërbimet ëeb dhe hosting në lidhje me pikat a, b dhe c. ;
përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit, duke përfshirë organizimin dhe zhvillimin e kurseve të kualifikimit dhe përmirësimit profesional në sektorët e veprimtarisë të përmendura në pikat a, b dhe c.;
Për të përmbushur qëllimin e aktivitetit të shoqërisë, kompania mund të kryejë, si shërbime dytësore, të gjitha veprimet që synojnë në mënyrë instrumentale arritjen e qëllimit të shoqërisë. Për këtë arsye, shoqëria mund: të blejë dhe të japë aksione në aktivitet që kanë lidhje direkte me objektin thelbësor të shoqërisë dhe gjithashtu në aktivitete të ngjashme dhe në çdo rast të lidhur me këtë objekt aktivitet, duke përfshirë blerjen ose shitjen e pjesëmarrjes ose të kuotave;
të eëalizojnë kurse formimi të shoqërive që kanë objekte të njëjta ose të ngjashme ose ndihmëse të tyre, të blejnë pjesëmarrje ose kuotat e tyre, të marrin pjesë në konsorciume, në grupime të përkohshme biznesi dhe në tendera publikë dhe privatë;
të paraqesin kërkesa për të përfitur nga lehtësirat dhe kontributet kombëtare dhe vendore;
të marrë kredi dhe në përgjithësi të shfrytëzojë çdo formë financimi nga institucionet financiare, nga bankat, nga kompanitë dhe nga individët, duke mundësuar të gjitha garancitë e luajtshme, pasuritë e paluajtshme dhe garancitë reale në përgjithësi, duke përfshirë dhe ofrimin e sigurimit të garancive.
Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër të nevojshme, të dobishme ose funksionale për përmbushjen e objektit të aktivitetit të shoqërisë të përmendura në nenin. 4.1.

Neni 5 – Kapitali Shoqëror

5.1 Kapitali i shoqërisë do të jetë 100,00 (njëqind euro) Euro ekuivalente me vlerën në Lek sipas kursit së këmbimit 123.3 lekë;

5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota tërësisht të nënshkruara në vlerë nominale sipas pjesëmarrjes së Ortakëve në kapitalin shoqëror.

Neni 6 - Pjesëmarrja dhe Kuotat

6.1 Pjesëmarrja në Kapitalin e Shoqërisë do të jetë e ndarë sipas mënyrës së mëposhtme:

Roberta Spada kontribuon vlerën në lekë 6.165 (gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë lekë), duke derdhur 50% të kapitalit të shoqërisë e barazvlefshme me nje kuota.

Angelo Costantiello kontribuon vlerën në lekë 6.165 (gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë lekë), duke derdhur 50% të kapitalit të shoqërisë e barazvlefshme me nje kuota.

6.2 Sipas pjesëmarrjes së sipërshënuar:

Ortakut **Roberta Spada** i takon një kuota, me vlerë nominale baraz me 6.165 (gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë lekë), e cila i korrespondon pjesës prej 50 % (pesëdhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë;

Ortakut **Angelo Costantiello** i takon një kuota, me vlerë nominale baraz me 6.165 (gjashtëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë lekë), e cila i korrespondon pjesës prej 50 % (pesëdhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë;

Neni 7 - Rritja dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Shoqërisë

Kapitali i Shoqërisë mund të rritet kur pjesëmarrësit në kapitalin bazë nënshkruajnë për kontributin në para ose në natyrë nëpërmjet emërimit nga Gjykata të një Eksperti të autorizuar për këto lloj kontributësh duke u bazuar në kërkesat e paraqitura nga Administratori.

Në asnjë rast dhe/ose rrethanë, shumica nuk mund të detyrojë një ortak të rrisë pjesëmarrjen e tij në kapitalin e shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit bëhet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendim duke ushtruar të njejtat kushte sic vendos për ndryshimet në Statut.

Gjithjësori, zvogëlimi i kapitalit i prek Ortakët në proporcion me pjesët takuese sipas pjesëmarrjes në kapital.

Neni 8 – Transferimi i Kuotave

Kuotat dhe të drejtat mund të blihen ose të transferohen nëpërmjet:

- pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë së autorizuar nga akti i themelimit të shoqërisë;
- blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- mënyrave të tjera të parashikuara në ligj.

Kuotat e kapitalit bazë janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përveç rastit nëse parashikohet ndryshe në Statut.

Kuotat e kapitalit bazë janë lirisht të transferueshme ndërmjet kapitalit.

Neni 9

Organi Vendimmarrjes

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës në Shoqëri.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i Shoqërisë që aprovon cdo ndryshim në Statut sipas mënyrave të parashikuara nga Ligji.

Asambleja e Përgjithshme merr vendim mbi çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:

- a) përcaktim i politikave të shoqërisë;
- b) ndryshim të Statutit;



- c) emërim dhe shkarkim të administratorëve;
- d) emërim dhe shkarkim të revizorëve dhe likuidatorëve të pavarur;
- e) përcaktim të shpërblimit për figurat në pikat "c" dhe "d";
- f) monitorim dhe supervizionim të zbatimit të politikave të shoqërisë nga ana e Administratorëve, përfshirë përgatitjen e bilancit vjetor dhe raportin mbi performancën;
- g) miratim të bilancit vjetor dhe të raportit të performancës;
- h) miraton shpërndarjen e fitimit vjetor;
- i) rrit dhe zvogëlon Kapitalin e Shoqërisë;
- j) ndarjen e kuotave dhe tërheqjen e aksioneve;
- k) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykim dhe në procedimet të tjera kundër Administratorëve;
- l) riorganizim dhe shkrirje të shoqërisë;
- m) miratim të rregulloreve të brendshme;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji ose nga Statuti.

Një ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme nga një tjetër Ortak i autorizuar ose nga një person i tretë po i autorizuar.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i një Ortaku në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë;

Autorizimi lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfshirë edhe rastin kur kjo Asamble rimblidhet.

Neni 10

Mënyra e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret me njoftim me shkrim me kthim përgjigje, ose me e-mail.

Njoftimi me shkrim ose me postë përmban vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe së bashku me rendin e ditës u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet në përputhje me nenin 1, Asambleja mund të marrë vendime vetëm nëse të gjithë Ortakët e Shoqërisë bien dakort të merrin vendimet pavarësisht parregullsive.

Neni 11

Kuorumi


Në rastet kur kërkohet shumica e zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse pjesëmarrja e tyre kalon 51% e kuotave të votës së nënshkruar. Në rastet kur kërkohet shumica e kualifikuar, në bazë të nenit 87, të Ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse pjesëmarrësit që kanë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave marrin pjesë personalisht në votim, me letër me kthim përgjigje ose me postë elektronike (e-mail) sipas nenit. 88, paragrafi 3, të këtij ligji. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk e arrin kuorumin e përcaktuar në nenin 1, mbledhja shtyhet por jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Mënyra e vendimmarrjes

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, lidhur më çështjet të tilla si ndryshimi i Statutit, rritja ose zvogëlimi i kapitalit bazë, shpërndarja e fitimit, organizimi dhe shpërbërja e shoqërisë, merr vendim me një shumicë tre të pestat e votave të Ortakëve pjesëmarrës në votim.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, merr vendim me shumicë të votave të pjesëmarrësve, në lidhje më çështje të tjera siç janë: Përcaktim i Politikave të Shoqërisë; Emërim dhe shkarkim i Administratorëve; Emërim dhe shkarkim i revizorëve dhe likuidatorëve të pavarur; Përcaktim të shpërblimeve; Monitorim dhe mbikëqyrje të zbatimit të politikave të shoqërisë nga ana e Administratorëve, duke përfshirë edhe përgatitjen e bilancit dhe të raportit të performancës; Përfaqësim të Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime



të tjera kundër Administratorëve; Miratim të rregullores së vet për procedurën e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Çdo ndryshim në Statut duhet të dorëzohet në QKR për të pasqyruar ndryshimet e bëra në dosjen e Shoqërisë.

Neni 13

Përrjashtim nga e drejta e votës

- 1) Një ortak nuk mund të votojë nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të:
 - a) marrë në shqyrtim performancën e tij;
 - b) se ai nuk ka përmbushur detyrimet e tij;
 - c) marrë në shqyrtim cdo lloj ankese kundrejt tij nga ana e Shoqërisë;
 - d) japë ose jo një benefit të ri;
- 2) Kur një Ortak përfaqësohet nga një i deleguar, ky i fundit do të konsiderohet në të njëjtin pozicion përse i përket konfliktit të interesit të ortakut që përfaqëson.

Neni 14

Administrimi

14.1 Me këtë akt emërohet në detyrën e Administratorit të shoqërisë, për një periudhë kohe prej 5 (pesë) vjeçare:

Roberta Spada qytetare italiane, me kartë identiteti AU4762275

14.2 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me përcaktimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", datë 14 prill 2008 dhe të nenit 14 të Statutit.

14.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha operacionet dhe detyrimet e nevojshme për themelimin e Shoqërisë në përputhje me legjislacionin dhe normativën në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori mund të përdorë ndihmën e palëve të treta dhe konsulentëve të cilëve mund t'u delegojë pjesërisht ose të gjithë kryerjen e aktiviteteve të lartpërmendura.

14.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë së themeluar deri në regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori është i autorizuar të nënshkruajë të gjitha aktet dhe të angazhohet në marrjen në emër të Shoqërisë së detyrimeve që do të rrjedhin që nga momenti i regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe t'u delegojë, ekspertëve të veçantë, kompetencat e tij.


Neni 15 – Gjuha

15.1 Ky akt Themelimi u hartua në dy (dy) kopje në gjuhën shqipe duke u bashkangjitur edhe përkthimin në gjuhën italiane.

15.2 për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumenteve të sipërpërmendura, versioni italian do të jetë i vetmi ligjërish i detyrueshëm.

ORTAKËT

Roberta Spada



Angelo Costantiello

